

Kronikë nga seanca e 16-të

Shkup, 27.04.2022 – Këshilli i Agjencisë në seancën e 16-të shqiptoi dy masa për vërejtje publike, si më poshtë:

- bazuar në konstatimet nga mbikëqyrja e rregullt programore ndaj SHTR Televizion Sitell SHPKPV Shkup për shkelje të nenit 55 paragrafi 5 nga LSHMAAV, dhe
- në pajtueshmëri me raportin me shkrim për mbikëqyrjen e rregullt administrative ndaj SHTR ALSAT- M SHPK Shkup për shkelje të nenit 14 nga Ligji për media.

Këshilli i Agjencisë miratoi dhe Qëndrimin e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale që pajtohet plotësisht me njoftimin për verifikimin e kryer të masave të marra në lidhje me rekomandimet e dhëna të përfshira në raportin përfundimtar të revizionit shtetëror të autorizuar, e vërtetuar në Agjenci me numër 03-839/2 nga 05.04.2022.